

Sammi  
Frasher  
VETORA

BIBLIOTEKA

8JH - 82  
F 06

1

ELINDJA

## Biblioteka RILINDJA

---

Redaktor

*Nazmi Rahmani*

*814-82  
F86*

# Sami Frashëri: VEPRA • I

BESA




RILINDJA  
Redaksia e botimeve  
P r i s h t i n ë  
1978

1874.13.2

Adam





## N J E R Z I J A

Vjeç

|              |                                     |                              |       |
|--------------|-------------------------------------|------------------------------|-------|
| ✓            | ZYBER:                              | Bari nga Progonati . . . . . | 55—60 |
| ✓            | VAHIDE:                             | E shoqja e Zyberit . . . . . | 35—40 |
| ✓            | MERUSHE:                            | Vajza e kätyre . . . . .     | 16—17 |
| ✓            | REXHEP:                             | I nip' i Zyberit . . . . .   | 17—18 |
| ✓            | SAIDE:                              | Një vajzë fqinjë . . . . .   | 16—17 |
| DEMIR BE:    | Nga parësi e Tepelenës . . . . .    | 50—60                        |       |
| TALHA:       | Kujdestari i Demir Beut . . . . .   | 40—50                        |       |
| SELFO:       | . . . . .                           | 20—22                        |       |
| XHAKO:       | . . . . .                           | 19—21                        |       |
| SULÇE:       | . . . . .                           | 25—30                        |       |
|              | (Trimat e Demir Beut)               |                              |       |
| ARSLLAN:     | . . . . .                           | 30—35                        |       |
| RAPO:        | . . . . .                           | 18—20                        |       |
| EVRENOS:     | . . . . .                           | 25—30                        |       |
| FETAH:       | Luftëtar nga Borshi, i at' i Selfos | 45—50                        |       |
| SELMAN:      | Një luftëtar nga Borshi . . . . .   | 30—35                        |       |
| DURI:        | Mëma e Fetahut . . . . .            | 80—90                        |       |
| NJË KALORES: | Suvari.                             |                              |       |



## PAMJ' E PARË

*Me të ngritur napën' e skenës duket një pyll, dhe majat e malevet për së largu.*

*Merushja ka ndenjur nënë hiet të një druri, e po bën çorape; pranë saj ka një lëkurë me qumësht, një trajstë dhe një kërabë.*

## Përflim I.

**MERUSHE, vetëm me vethë.**

Edhe më s'u-duk; së ndenjuri vetëm, m'u-brengos shpirti. Kur është i brengosur njeriu, sa i zgjatet ko-ha! Një orë, sa një muaj i duket... Nuk e di ç'më qe kshu? Më parë që në mëngjes e gjer sa ngrysej rinja fillja vetëm, dhe nuk donja të dinja fare; po më vinte mirë, se qetësohesha kshu. Kur shpinja dhëntë më no një kullotë të mirë, vetë rinja e gjëzuar nënë hiet të no një peme; nuk e dinja ç'ish brengë fare; Bukuri e malit, oshëtim'i pérënjet, ligjerim'i zogjet, blegërim'i shqeravet më dëfrenin mëndjen, më zbativnin shpirtin! S'kisha gjë në mënt, veç shqerat, dhëntë, dhe tjetër s'mejtonja. Pa le, kur pillte nonjë dele s'kish më e lumtur se unë! Mbrëmanet, me të kthyer në shtëpi, po të shpinja nonjë qengj në prehër, atë ditë e

quanja të shënuar. Kur më sëmurej nonjë qengj, a kur ftonim njeri e donte të therte im' atë, unë hidhë-rohesha. Në kohërat të para gjith' e gëzuar, e qeshuri sha; po tani, s'di se pse? dhëntë m'u xvertitnë, më duallë nga zemra, më s'dua t'i shoh. Gjithë mëndjen tek ai e kam! Kur e kam pranë e humbas fare; ç'bënj, ç'flas as unë s'e di! Kur s'e kam, vetëm atë mejtonj, tjatër gjë s'më hyn në sy. Kohën e pres pa durim, ora si muaj më duket. Ah! Perëndi! ç'është kjo punë kësh-tu? Më parë dhe nga tim më e nga tim atë më tepër e donja, e kisha si vëlla; po tani... Ah! as Vethes sime s'kuxonj t'ja them!... Kur i vdiq eëma dhe i ati e lanë të vogël; im' më na rriti të dyve bashkë; im' atë me një sy na shikon, më të shumët e njerëzisë vëllezër na dinë; ashtu vërtet; si vëllezër jemi ritur, bashkë kemi ngrën' e kemi pirë, gjer më dje në një shtresë flinim... Ah! unë nga Rexhepi duhet ta pres shpresën... Po s'e bënj dot... Vdekja është më e mirë përpara ndarjes!... Pa nesër a pasnesër në e zënçin Rexhepnë, ati n'i dhëncin nonjë tjetër, dhe mua në më vlofçin me nonjë tjetër... Ah! unë s'rronj pa të!

*Zë sytë me dorë dhe mallëngjehet. Rexhepi duke vëshëllyer del nga anë e djathët.*

## Përflim II.

*MERUSHE, REXHEP.*

*REXHEP, nxiton dreq Merushes.  
Merushe!*

*MERUSHE, për njëherë ngrihet dhe fshin sytë.*

*Ah! Rexho! ti je? Ku mbete kaqë?*